



## Karakteristika të disa foljeve në gjuhën shqipe që marrin argumente fjaliore

Brikena Liko

Faculty of History and Philology, University of Tirana, Editor, Academy of Sciences of Albania, Tirana, Albania

### Abstract

Në këtë kumtesë me temë nga sintaksa e gjuhës shqipe synohet të trajtohen veçoritë dhe struktura argumentore e disa foljeve të shqipes, të cilat marrin argumente të realizuara me sintagma komplementuese ose eptimore me vlerën e një fjali, pra folje të fjalisë drejtuese që i plotësojnë valencat e tyre me fjali argumentore. Qëllimi i trajtësës është që, bazuar në korpusin e marrë në shqyrtim, të vihen në dukje karakteristikat e përbashkëta të këtyre foljeve në gjuhën shqipe, ku dallojnë nga foljet e tjera që nuk pranojnë si argumente sintagma me vlerë fjaliore dhe të shqyrtohen gjithashtu disa raste kur të njëjtat folje të këtij tipi paraqesin struktura të ndryshme argumentore.

Metoda e përdorur është analiza dhe përshkrimi, ndërsa materialet e shfrytëzuara janë vjelë nga disa romane të letërsisë shqipe bashkëkohore, por edhe nga publicistika.

**Keywords:** sintaksë, fjali argumentore, sintagma komplementuese, sintagma eptimore, strukturë argumentore e foljes

### Introduction-Hyrje

Klasifikimi i përbërësve të frazës në argumente dhe në përbërës shtesorë është rezultat i teorisë së valencës, koncept i mirënjohur tashmë në gjuhësinë tonë<sup>[1]</sup>. Sipas kësaj teorie një zë i caktuar leksikor duhet të shoqërohet nga një numër i caktuar argumentesh, të cilat janë njësitë e përfshira drejtpërdrejt në procesin e përshkruar nga folja dhe janë të detyrueshme (Graffi, 2003: 62)<sup>[3]</sup>. Predikati është përkufizuar si një përbërës që tregon një veprimtari apo ngjarje, ndërsa argumenti është një përbërës që tregon një pjesëmarrës në veprimtarinë apo në ngjarjen në fjalë (Radford, 2009: 157)<sup>[8]</sup>. Në gjuhën shqipe, në rolin e predikatit, përveç foljes, mund të jetë edhe një emër (prejfoljor), mbiemër ose parafjalë (Buxheli, 2007: 190)<sup>[11]</sup>.

Është e vërtetë se *struktura argumentore përcakton numrin e përbërësve të nevojshëm për një fjali, por jo domosdoshmërisht tipin e këtyre përbërësve* (Haegeman, 1998: 44)<sup>[4]</sup>. Nga njëra anë këto argumente mund të realizohen me sintagma të ndryshme, emërore, parafjalore dhe ndajfoljore (në rastin e lokativëve (Kananaj, 2015)<sup>[5]</sup>, por edhe me sintagma komplementuese dhe foljore (edhe fjalitë e nënrenditura me forma të pashtjelluara). Nga ana tjetër jo të gjitha foljet mund të marrin të gjitha llojet e argumenteve, jo të gjitha foljet mund të marrin si argument një fjali.

<sup>1</sup> I sjellë në gjuhësi fillimisht nga Tesnieri, përpunuar më tej nga drejtimi gjuhësor i quajtur "gramatika e varësisë" (angl. *dependency grammar*) (Crystal, 2008: 137): Term i huazuar nga kimia, i sjellë në gjuhësi për herë të parë nga gjuhëtari francez Lucien Tesnière (1893–1954) dhe më pas nga gramatika gjenerative. Valenca është një koncept i futur fillimisht në gjuhësinë strukturaliste, por i rimarrë në gjuhësinë gjenerative. Më herët studiuesit kanë bërë dallimin midis këtij koncepti në të dyja drejtimet. Shih: (Memushaj, 2008: 153-170), i cili te dallimi i sintaksës gjenerative nga modelet e mëparshme, midis të tjerash, te tri shtyllat e sintaksës së sotme, rendit edhe konceptin e valencës dhe të roleve tematike që burojnë prej saj. Këtu valenca ka kuptimin e përpunuar nga gjuhësia gjenerative.

### Karakteristikat e strukturës argumentore të foljeve që marrin argumente fjaliore

Aftësia e foljes për të marrë një, ose disa argumente fjaliore (nënkuptojmë sintagmat me vlerë predikative – sintagma komplementuese, eptimore, me folje të pashtjelluara) varet në radhë të parë nga: a) kuptimi, b) rrjeta e tyre semantike dhe lloji i roleve që ato mund të caktojnë. Nga gjithë studimet që u jemi referuar dhe që kemi përdorur si model për analizat tona, ne mbështesim qëndrimin se struktura argumentore e foljes varet nga kuptimi i foljes që është i lidhur ngushtë edhe me kontekstin ku ajo folje shfaqet.

Argumentet e shprehura me fjali mund të tregojnë përgjithësisht nocione abstrakte, veprime, gjendje etj. Por nuk mund të ndodhë që ato të tregojnë objekte konkrete dhe as persona. Ndaj edhe roli tematik që u caktohet atyre u përket këtyre kategorive, kryesisht rolit semantik të *temës*. Prandaj, një folje si *dërgoj* kërkon patjetër një dërgues që të jetë një person, grup personash (po ta përgjithësojmë mund të themi se ky dërgues mund të jetë edhe një pajisje *me inteligjencë* si telefoni, kompjuteri etj.) dhe kërkon gjithashtu një marrës shpesh me po të njëjtat cilësi të dërguesit. Ajo që dërgohet do të jetë një objekt konkret ose mesazh. Asnjë nga këto argumente nuk mund të realizohet nga një fjali.

P.sh., një folje si *qep* e përdorur me kuptimin e parë që ka në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* 2006 (qep kal., -a, -ur 1. kap me pe të shkuar në gjilpërë anët e copave prej pëlhure, prej cohe, prej lëkure, një kopsë etj.) kërkon që një nga argumentet e saj të jetë në gjendje ta kryejë këtë veprim (që mund të jetë [+human], por edhe [+makineri] e drejtuar nga një [+human]), kërkon një objekt X [+konkret] që ta pësojë këtë veprim, gjithashtu (por jo medoemos)<sup>[2]</sup> kërkon një përfitues Y që mund të jetë

<sup>2</sup> Pavarësisht se flasim për argumente, të cilët mendohet të jenë të domosdoshëm në strukturën e frazës, në rastin e kundërinorit të zhdrejtë të strukturave argumentore me folje të këtij tipi, mund të jetë ose jo i pranishëm (*Rrobaqepësja qep fustanin. Mami i qep fustanin vajzës*). Kur kemi folur për

[+frymor], ose me aftësinë për të përvetësuar a për të përdorur realien që shprehet nga argumenti Y, por që kurrsesi nuk mund të jetë e realizuar me një fjali të nënrenditur.

Meqenëse jo të gjitha foljet mund të marrin si argument një fjali të nënrenditur, për shkak të natyrës së tyre kuptimore dhe rrjedhimisht roleve tematike që duhet të "shkarkojnë", rrjeta e tyre semantike dhe struktura argumentore ndryshon nga ajo e foljeve të tjera që e kanë këtë veti.

Nuk është e thjeshtë të shpjegosh natyrën kuptimore të asaj çfarë shpreh një folje, pasi kjo bëhet me anë të zbrërthimit të njëpasnjëshëm të përkufizimeve të kuptimeve dhe nuancave kuptimore të saj. P.sh. folja *imitoj* në kuptimin e saj të parë nuk tregon thjesht një veprim, por një "veprimtari", një tërësi veprimesh të ndërjegjshme (pasi përshkrimi i zërit në fjalor është "bëj diçka pikë për pikë si e bën ose si e ka bërë një tjetër, riprodhoj në mënyrë të përpiktë a shumë të ngjashme lëvizjet, sjelljen, veprimet etj. Pra, sipas këtij përkufizimi, kur përdoret me kuptimin e saj të parë, në strukturën kuptimore të kësaj foljeje kërkohet një imitues, që duhet të ketë aftësinë për ta kryer këtë dhe dikë që imitohet. Por në kuptimin e dytë të saj, ndryshon struktura semantike e pjesëmarrësve në këtë veprimtari, sepse ata nuk kanë më domosdoshmërisht tiparin [+njeri], por mund të jenë edhe pajisje. Pra një folje, dy kuptime, dy struktura të ndryshme semantike. Kjo folje nuk mund të marrë si argument një fjali të nënrenditur, pasi argumentet e saj duhet të jenë realie konkrete, dhe jo abstrakte, siç është koncepti që mund të shprehë një fjali e nënrenditur.

Folja *flas* është një folje ku valenca gramatikore nuk barazohet me valencën kuptimore. Ajo kuptimisht kërkon dy argumente, personin që flet me karakteristikën [+njeri] dhe personin ose personat që e dëgjojnë që duhet të ketë aftësinë e të dëgjuarit. Në rastin kur kemi shprehjen vetëm të argumentit të jashtëm, dhe folja del njëvalente nga pikëpamja gramatikore, argumenti i brendshëm një nga mbushësit e valencës kuptimore nënkuptohet të jetë vetë folësi, që është edhe veprues edhe përfutues, por mund të jetë edhe dikush tjetër në rast se këtë na e lë konteksti ta kuptojmë. *Unë flas*.

Rast i dytë kur përputhet valenca kuptimore me atë gramatikore, është rasti me strukturë argumentore [SE<sub>emërore</sub>, SE<sub>dhanore</sub>]. Mirëpo, pavarësisht se kjo folje mund të marrë një argument të jashtëm dhe një argument të brendshëm.

*Unë i flas asaj*.

Mirëpo kjo është një folje që e përdorur në këtë kuptim të parë, pavarësisht dy valencave kuptimore, ajo nuk mund të marrë një fjali si argument. Ndryshe qëndron puna me një folje e ngjashme kuptimisht me të, folja *them* paraqet një strukturë tjetër argumentore.

Folja *habit* ka një strukturë të veçantë argumentore, ajo mund të marrë si argumente 2 sintagma emërore, por edhe një sintagmë emërore dhe një sintagmë lidhëzore. E veçanta e saj është se mundësinë për të marrë sintagmë lidhëzore ajo e ka në pozicionin e kryefjalës, jo kundrinorit. Po kështu folja *realizoj* që ka dy valenca qoftë kuptimore, qoftë gramatikore. Ajo i plotëson në të dyja rastet pozicionet e argumenteve nuk i

plotëson asnjëherë me fjali të nënrenditur.

### Modele të strukturës argumentore të foljeve që marrin si argumente sintagma komplementuese

Më poshtë do të shohim disa nga foljet që marrin si argument një fjali të nënrenditur, disa karakteristika të strukturës së tyre argumentore, disa kombinime të mundshme të realizimeve konkrete të këtyre argumenteve të ilustruara me shembuj tipikë e për të dalë në fund me disa përfundime të përgjithshme.

Përgjithësisht foljet që kërkojnë për veprues, përjetues apo agjent një emër me tiparin [+human], nuk dalin me fjali të nënrenditur në pozicionin e argumentit të jashtëm. Të tilla janë foljet dhe shprehjet foljore, si: *dëshiroj, akuzoj, aspiroj, ëndërroj, ngurroj, pyes, them, sugjeroj, më vjen inat, më vjen mirë, marr vesh, bën mirë (që), lexoj, harroj, guxoj, vdes* <sup>[3]</sup> etj. Duhet të theksojmë se ky konstatim bëhet vetëm për formën veprare të këtyre foljeve, pasi, siç është shpjeguar edhe më herët, gjatë kalimit në joveprare ndodhin transformime të tilla që bëjnë të mundur edhe kombinime të tjera të përbërësve në strukturën argumentore të asaj foljeje (ose të paktën për sa i përket realizimit të jashtëm të tyre, jo pozicioneve origjinale të gjenerimit).

Bazuar në veçoritë më tej të foljeve, nga valenca dhe lloji i argumenteve që mund të marrin (kur një prej tyre është fjali e nënrenditur), frazat argumentore mund të klasifikohen në fraza argumentore që kërkojnë përbërës predikativë argumentorë - kundrinor të drejtë, - të zhdrejtë apo të drejtë dhe të zhdrejtë njëkohësisht. Përveç kësaj ato mund të dallohen edhe sipas llojit të sintagmës me të cilën mund të realizohet secili nga të tri argumentet.

Më poshtë do të shihen disa prej foljeve që mund të marrin si argument një ose disa fjali të nënrenditura, do të shohim disa shfaqje të strukturave të tyre argumentore dhe shembuj përkatës. Kjo mund të bëhet edhe për folje të tjera që marrin si argument një sintagmë komplementuese - SK, apo sintagmë foljore të pashtjelluar - SFpsht.

**(më) takon:** Në këtë trajtë kjo është një folje që merr SK argumentore me funksion kryefjalë vetëm në rast se ka një sintagmë emërore në dhanore në funksionin e kundrinorit të zhdrejtë dhe rrjedhimisht me praninë e trajtës së shkurtër përkatëse. Ajo mund të paraqesë strukturën argumentore [SE<sub>dhan</sub>, SK<sub>argumentore</sub>-kryefjalore] si te shembulli:

*Më takon mua ta bëj këtë të fundit.*

Në pozicionet e argumenteve dalin edhe sintagma emërore, por, përveç fjalive kryefjalore, nuk del asnjëherë me sintagmë komplementuese në funksionin e kundrinorit të drejtë.

**besoj:** Edhe kjo folje del me disa struktura argumentore, pozicionet e argumenteve mbushen edhe me sintagma emërore, edhe me sintagma komplementuese.

[SE<sub>emërore, human</sub>, SE<sub>kallëzore, human</sub>]: *Ai beson të bijën. Ai beson vetëm atë.*

[SE<sub>emërore, human</sub>, SE<sub>dhanore, human</sub>]: *Ai i beson së bijës.*

[SE<sub>human</sub>, SK<sub>kundrinore</sub>]: *Ai beson [SK se do të zbardhet e vërteta].*

**Dëshiroj:** [SE<sub>human</sub>, SK<sub>kundrinore</sub>] Kjo folje del kryesisht me fjali

valencën e foljes, kemi mbështetur dallimin e valencës së foljes me strukturën argumentore të predikatit. Edhe në raste si ai i foljes *qep*, do të bëhej dallimi, pasi folja *qep* është folje trivalente, pra i ka tri "vende", por mund të marrë dy ose tri argumente, duke mbajtur të njëjtën nuancë kuptimore.

<sup>3</sup> Me kuptimin *dëshiroj shumë*. Shih përdorimin dhe strukturën argumentore të saj më tej.

argumentore si argument të dytë, por edhe me një sintagmë emërore që zëvendëson fjalinë e nënrenditur, më tepër me folje të emëruara.

*Kur dikush, ndërkaq, dëshiron [SK të merret me një çështje të tillë aq të ndërlikuar], atëherë ai duhet jo vetëm të njohë letërsinë, po dhe të ketë kulturën e nevojshme kritike, teorike, estetike dhe filozofike.* (R. Qosja, Anarkia e kritereve, 1973 - A.C.\*)

**kërkon:** Shfaq disa kombinime të ndryshme, midis të cilave është edhe ai me dy fjali të nënrenditura argumentore, njëra me funksion kryefjalë e tjetra kundrinor.

[SE, SE, SE]

*I kërkoi çantën.*

[SE, SE, SK]

*Ajo i kërkoi vajzës [SK të bëjë detyrat].*

[SK, SK], në rastin kur vendi i argumentit të jashtëm përmbushet nga një sintagmë komplementuese, kjo folje mund të paraqitet me dy valenca, pavarësisht llojit të argumentit të brendshëm.

*[SK Të jesh i suksesshëm] kërkoi [SK të punosh sistematikisht].*

[SK, SE]

*[SK Të jesh i suksesshëm] kërkoi punë sistematike.*

**Akuzoj:** Kjo folje nuk merr në pozicionin e parë të argumentit një fjali të nënrenditur, thënë ndryshe nuk merr fjali në pozicionin e kryefjalës. Kombinimi i vetëm me fjali të nënrenditur është: [SE, SK]. Arsyeja është sërish te kuptimi i saj, ajo shpreh një qëndrim që mund të mbahet vetëm nga një njeri ose grup njerëzish në kuptimin e gjerë.

*Ai akuzohet [SK se ka dërguar milicë në luftën civile jugosllave në fillim të viteve '90].* (Gazeta Shqiptare, 2006.11.26 - A.C.)

**Aspiroj:** I njëjti shpjegim si për foljen *akuzoj* qëndron edhe për foljen *aspiroj*.

*Megjithatë, shteti më i ri në Evropë, i cili aspiroi [SK të anëtarësohet në NATO], ka shumë prioritete të tjera për të zgjidhur në vend, para se të nisë rrugën e gjatë drejt kësaj Aleance.* (Zëri, 2013.03.07 - A.C.)

**bën mirë (që):** Një nga foljet, në strukturën argumentore të së cilës nuk shfaqet një fjali e nënrenditur në pozicionin e argumentit të jashtëm. Ajo del kryesisht me kombinimin [SE, SK].

*Ti bën mirë [SK që i gris dhe i mbledh shuk ato] që nuk të pëlqejnë.* (D. Agolli, Trëndafil...)

*Bën mirë [SK që mbledh ushtarët e vvarë], sepse çdo rob i Perëndisë duhet të prehet në vend të vet.* (I. Kadare, Gjenerali...)

Kjo është një nga shprehjet foljore që si argument të brendshëm apo kundrinor të drejtë nuk marrin asnjëherë një SE: \*[SE, SE], \*[SK, SE], \*[SK, SK]. Por në përdorimin *Kjo i bën mirë vajzës. Të jesh sistematik i bën mirë kujtesës*, që është e dukshme se kanë një dallim kuptimor, edhe kombinimet: \*[SE, SE], \*[SK, SE].

**dëftej:** Ka tri vende argumentesh, si argument të parë, të

jashtëm, mund të marrë kryesisht me funksionin e kryefjalës mund të marrë një përbërës me tiparin [+human], por edhe një sintagmë komplementuese që tregon një veprimtari. Kemi gjithsesi një vend bosh, një argument që nënkuptohen, pasi veprimi që shpreh folja kërkon patjetër një marrës mesazhi (i dëftehet dikujt, njësoj si me foljen *tregoj*, *them* etj. të cilat nga ana kuptimore mund të kenë një valencë më tepër se ajo që realizohet në ligjërim).

[SE<sub>emërore</sub>, SK, SE<sub>dhan.</sub>]:

*Ky e pi në syt' tonë, që të na dëftejë [SK se është akoma gjallë].*

(P. Kulla, Rrëfenja...)

[SK, SK, -] Edhe këtu vihet re se si një fjali e nënrenditur në pozicionin e argumentit të jashtëm, paraqet një strukturë argumentore me dy vende.

*[SK Të kërkosh belanë me vetëdije] dëften [SK se nuk je aspak i matur].*

Të njëjtën strukturë argumentore me foljen *dëftej* paraqesin përgjithësisht edhe foljet *dëshmoj*, *tregoj*.

**dëshmoj:** [SE, SK, -] [SE Këto tipare] dëshmojnë [SK se ajo është ngritur në një shkallë të re historike]. (R. Ismajli, Në gjuhë...).

**tregoj:** [SE, SK, -] *Më pas, [SK tregojta se isha edhe i pafajshëm].* (G. Sh., 2006.12.02)

**detyroj:** Folja është e veçantë për sa i përket strukturës argumentore, pasi në vështrim të parë duket sikur është trivalente: X detyron Y SK<sub>[që,të, për të]</sub> si te shembulli: [SE Zbatimi i Marrëveshjes së arritur në Bruksel] detyron [SE<sub>2</sub> Beogradin] [SK<sub>të</sub> ndryshojë një numër të madhe ligjesh]. me strukturën argumentore [SE, SE, SK].

Mirëpo për këtë dukuri në shqipe ka folur Buxheli (2007)<sup>[1]</sup>, e cila sintagmën e dytë emërore nuk e quan argument të foljes së parë, por të foljes së fjalisë së nënrenditur. Këtu nuk do të ndalemi në këtë çështje, por do të theksojmë vetëm se folja na del dyvalente nëse e shohim nën këtë këndvështrim.

**di:** Është dyvalente. Si një folje që shpreh diçka të realizueshme vetëm nga një qenie e gjallë me ndërgjegje, në vendin e argumentit të parë nuk mund të ketë kurrsesi një sintagmë komplementuese. Ndërsa në pozicionin e argumentit të dytë mund të dalë edhe një sintagmë komplementuese edhe një sintagmë emërore.

[SE<sub>human</sub>, SK<sub>kundrinore</sub>]: *Me siguri, nuk e dinte se i kishte të grisura.* (Dh. Xhuvani, Kupa...)

[SE<sub>human</sub>, SK<sub>kundrinore</sub>]: *Çdo nxënës shkolle e di përmendësh këtë vjershë...* (I. Kadare, Muzgu...)

Por kjo folje del edhe me një përdorim trivalentësh në rastin: [SE<sub>human</sub>, SE<sub>1</sub>, SE<sub>2</sub>] *Fëmija nuk ia di kuptimin asaj fjale.* Në këtë kuptim që vjen sinonim me foljen *njoh* ajo nuk mund të ketë në strukturën e vetë argumentore një sintagmë komplementuese.

**guxoj:** përgjithësisht është një folje që si argument të brendshëm merr vetëm një fjali të nënrenditur, si argument të parë një SE që zotëron tiparet e përshtatshme për aftësinë që shpreh kuptimi i foljes. Edhe kjo futet te foljet që si argument të jashtëm nuk marrin një SK. Pra struktura e saj argumentore

\* Simboli A.C. tregon se burimi i shembujve është nga korpusi online Albanian Corpus (<http://web-corpora.net/AlbanianCorpus>).



është: [SE, SK]

*Mos guxo* [SK të bësh zgjedhje]. (Tema online, 27.04.2017)

**informoj:** Kjo folje del me strukturën [SE, SE], por edhe [SE, SK]. Futet tek ato folje që si argument të jashtëm nuk mund të kenë një sintagmë komplementuese, por një përbërës me aftësinë e këtij veprimi (të njëjtën strukturë paraqet edhe folja *njoftoj*).

[SE, SK] *Kryeministri Berisha informoi* [SK se do të ngrihet një grup ekspertësh] për të përgatitur një paketë propozimesh drejtuar opozitës... (G.Sh. 2006.12.23)

[SE, SE] ...[SE1 gjykata] informon [SE2 organin kompetent], i cili disponon dhënien e dokumenteve, akteve apo sendeve të tjera, ose konfirmon mungesën e tyre. (Ligj nr. 35/2017..., f. 33.)

**harroj:** Folje dyvalente që kërkon si argument të jashtëm një përbërës që zotëron aftësinë për të harruar (njeri, por edhe kafshë), prandaj ky pozicion nuk mund të mbushet nga një sintagmë komplementuese. Pozicioni i argumentit të brendshëm mund të mbushet nga një sintagmë komplementuese, por edhe nga një sintagmë emërore. Realizimet e mundshme:

[SE, SK] *Kur e solli verën, nxora paratë dhe i vura mbi tryezë, duke i kërkuar të falur që kisha harruar* [SK të paguaja drekën]. (D. Agolli, Trëndafil...) )

[SE, SE] *Katër muaj me pas, [SE Klaus] mund ta kishte harruar* [SE2 premtimin]... (I. Kadare, Darka...)

Edhe folja *ëndërroj* paraqet të njëjtat tipare si folja *harroj*. *Ëndërronte* [SK që të shkonte në koleg dhe që të bashkohej me Trupat e Paqes]. (Zëri, 2013.04.23)

**Vdes:** Është një folje që në kuptimin e parë merr vetëm një argument të jashtëm, kryefjalën. *Vdes* (në kuptimin e figurshëm *dëshiroj shumë*) mund të marrë si argument të brendshëm edhe një sintagmë parafjalore, edhe një sintagmë komplementuese.

[SE, SP] *Ai vdes për ëmbëlsira. Ajo vdes për ty.*

[SE, SK] *Unë vdes* [SK të gatua].

Kjo folje, në këtë kuptim nuk del asnjëherë me një argument të shprehur me sintagma të tjera veç atyre me vlerën e një fjalisë. Rasti kur del me sintagmë parafjalore, duhet parë si argument për shkak të domosdoshmërisë në frazë të këtij përbërësi dhe sepse ai e merr një rol tematik nga folja.

☛ Raste të veçanta janë ato të foljeve që, edhe pse njëvalente, marrin, përveç kryefjalës (si argument i parë), edhe një argument tjetër të realizuar me fjali të nënrenditur. E tillë është folja *ngurroj*.

*p.sh.*

*Fatkeqësisht, edhe përkundër faktit që shqiptarëve kjo e drejtë u sigurohet edhe me ligj, ata ende ngurrojnë* [SK të shfrytëzojnë edhe ato drejta] që u garantohen. (Zëri, 2013.10.31)

**gjykoj:** Folje dyvalente që del me disa struktura argumentore. Për sa i përket fjalive të nënrenditura argumentore, ajo del me variantet [SE, SK]. Në pozicionin e argumentit të jashtëm kjo folje nuk del me sintagmë komplementuese, por në formën e saj veprorë mund të dalë me një fjali kryefjalore, por që gjithsesi gjenerohet në pozicionin e argumentit të brendshëm

(siç do të shihet në sythin përkatës të fjalive kryefjalore).

[SE, SK] ...*nuk janë aspak në gjendje të gjykojnë* [SK se cili besim është më i miri] (Historia e popullit...)

*Ndonëse parimisht nuk mund të vendosim për një ndjenjë, sërish gjykojmë* [SK se ndjenjat nuk janë vetëm një fat] që të bie dhe që detyrimisht duhet mbajtur apo vuajtur. (M. Meksi, Të biesh...)

[SE, SE] [SE1 Gjukata e krimeve të rënda] gjykon [SE2 krimet e parashikuara nga nenet 73, 74, 75, 79]. (KPRSH, L. 7905)

**dua:** [SE, SK] *BE-ja na ka thënë të dyja palëve* [SK që të veprojmë në mënyrë fqinjësore] nëse duam [SK të bëhemi anëtarë të BE-së]. (Zëri, 2013.03.26)

Folja *dua*, në kuptimin "kërkon" del edhe me një fjali të nënrenditur në pozicionin e argumentit të jashtëm [SK, SE], por del edhe me SK në të dyja pozicionet:

[SK, SE] [SK Të vazhdosh jetën normalisht pas një fatkeqësie të tillë], do shumë vullnet.

[SK, SK] [SK Të edukosh fëmijët në një kohë kaq të trazuar, do që të marrësh përsipër shumë përgjegjësi.]

**duket:** Rasti i kësaj foljeje është i veçantë, ndaj nuk mund të trajtohet këtu. P.sh. në shembullin më poshtë, pavarësisht se duket sikur ka strukturën [SE, SK], sintagma emërore në fillim të frazës nuk është argument i kësaj foljeje, por argument i foljes *ndryshoj* të fjalisë së nënrenditur:

*Ai duket* [SK se ka ndryshuar rendin e ditës dhe nuk ka folur në prezencën e kryetarit të shtetit]... (G. Sh., 2006.12.08)

Këtë folje, bashkë me foljet e ngjashme *ngjaj*, *ndodh* etj. do të trajtohen në sythin përkatës për fjalitë kryefjalore.

**jap leje / lejoj:** Në kuptimin e parë që ka në fjalor e parashikon në strukturën e vet argumentore një fjali të nënrenditur si argument i tretë, *unë lejoj dikë të bëjë diçka:* [SE emërore, SE kallëzore, SK]

*Ai do të vriste apo do të lejonte* [SK të vritej], do të vetëburgosej, apo do të dilte prej burgut kur ta quante të nevojshme. (I. Kadare, Kush e solli...)

Kjo folje del edhe me një sintagmë komplementuese në pozicionin e argumentit të parë, pra merr një fjali kryefjalore në formën e saj veprorë:

[SK, SE / SKI\*, SK] [SK Të përfundosh me rezultate të shkëlqyera] të lejon [SK të vazhdosh ciklin e dytë të studimeve]. Por del edhe me strukturën [SE, SE], ku kemi vetëm dy argumente:

arg.1.) SE ligji,

arg.2.) SE zbatimin e urdhrin penal të dënimit.

[SE, SE] ...i pandehuri akuzohet për një vepër penale, për të cilën ligji nuk lejon [SE zbatimin e urdhrin penal të dënimit] (Ligj. nr. 35/2017, f. 68)

Po kështu edhe shprehja foljore *jap leje*:

*Tashi pra kësaj here dha lejë Mitropolija rumune* [SK të meshohej shqip në një kishë të vjetër të Bukureshtit, të cilës i theshnin Shën-Gjergji-i-Vjetër. (L. Poradeci, Himni...)

**këmbëngul:** Kjo folje, në strukturën e saj argumentore mund të marrë si argument të dytë një fjali të nënrenditur folja e së cilës është në formën e pashtjelluar:

\* SK<sub>x</sub> të lejon (ty) SK<sub>x</sub>.

[SE, SF<sub>psh</sub>] *Meqë qeveria vazhdoi të këmbëngulte [SF<sub>psh</sub> për të mbledhur taksat] dhe [SF<sub>psh</sub> për të zbatuar masat e reja]...* (Historia e popullit shqiptar, vëll. II)

Por del edhe me strukturën [SE, SK]:

*Por, Kosova mbetet ligjërisht pjesë e Serbisë dhe serbët këmbëngulin që kjo të mos ndryshojë* (G.Sh., 2006.11.14)

**mjafton:** Kjo folje merr sintagmë komplementuese si argument, por në formën veprorë merr fjali argumentore kryefjalore, ndërsa në formën e saj joveprorë nuk pranon një sintagmë komplementuese si argument.

*Mjafton [SK që të jeni të gjithë].*

**lexoj:** Merr edhe SE, edhe SK si argument të dytë: *Lexova librin. Lexova [SK se ka ndryshuar procedura e pranimit në universitet].*

**parashikoj:** Kjo folje mund të marrë edhe një SE, edhe një SK me komplementues të shprehur të domosdoshëm, edhe një SK me komplementues të pasprehur, por që mund të vendoset lehtësisht, kryesisht me folje në lidhore.

[SE, SE] *Parashikon të ardhmen.*

[SE, SK] *Në kontratën kolektive mund të parashikohet që të gjitha përfitimet që rrjedhin prej saj ose një pjesë e tyre janë të vlefshme gjatë kohëzgjatjes së kontratës.* (Kodi i Punës..., L. 7961)

**pyes:** [SE<sub>human</sub>, SE<sub>human</sub>] *Unë pyes mamin.*

[SE<sub>human</sub>, SL<sub>kundrinore</sub>] *Unë pyeta nëse do të vijmë edhe ata.*

**shpresoj:** [SE<sub>human</sub>, SL<sub>kundrinore</sub>]

Disa folje në formën e tyre veprorë nuk marrin fjali të nënrenditur si argument, por me kalimin në joveprorë ato e fitojnë këtë aftësi. E tillë është p.sh., folja *shikoj* e cila vetëm në situata tepër të veçanta mund të dalë në shembujt: *Shiko [SK të bësh mirë detyrat], pastaj flasim për shëtitjen.*

Ndërsa në formën e saj joveprorë ajo e merr lehtësisht një sintagmë komplementuese si argument: *Shikohet [SK se kanë të gjitha të njëjtën strukturë].*

Folje të tjera që marrin si argument një fjali të nënrenditur janë foljet, si: *mendoj, meritoj, mësoj, shpresoj, shtoj, refuzoj, rekomandoj, rezulton (veta II), rrezikoj, saktësoj, shkruaj, shpall, shpjegoj, raporto, parashikoj, përpiqem, pëshpërit, planifikoj, pranoj, pres, pres / prit, pretendoj, pretendoj, prit, propozoj, mohoj, mundësoj, ndaloj, ndihmoj, ndikoj, nënvizoj, ngjan, kujtoj, kuptoj / nënkuptoj, paralajmëron, parapëlqej, pëlqej, kujdesem, marr vesh (dëgjoj), më vjen inat, mendoj, sigurohem, sugjeroj, synoj, theksoj, them, urdhëroj, uroj, vazhdoj, vë në dukje, vendos, vlerësoj, vërtetoj, zbuloj* etj.

### Përfundime

Nga shembujt dhe vështrimet përkatëse në strukturat argumentore të këtyre foljeve që marrin si argument një sintagmë komplementuese (pa synuar një trajtim shterues, që mund të përbente një punë kërkimore më vete), mund të nxirren këto karakteristika të përgjithshme:

- Foljet që në pozicionin e argumentit të jashtëm (atë të kryefjalës) nuk mund të marrin një SK, janë kryesisht folje që shprehin një veprim, gjendje etj. e cila kërkon një

sintagmë emërore që shënon një qenie të gjallë me aftësinë për ta kryer, përjetuar etj. atë që shprehet nga folja. Të tilla folje përmendim: *dëshiroj, akuzoj, aspiroj, ëndërroj, ngurroj, pyes, them, sugjeroj, më vjen inat, më vjen mirë, marr vesh, bën mirë (që), lexoj, harroj, guxoj, vdes etj.*

- Disa folje përgjithësisht mund të kenë si argument të brendshëm vetëm një fjali të nënrenditur. Këtu futen edhe disa folje që bëjnë pjesë te grupi i mësipërm që nuk mund të marrë si argument të jashtëm një SK. Të tilla folje e shprehje foljore mund të përmenden: *dëshiroj, ngurroj, guxoj etj.*
- Ka folje që mund të marrin si argument një fjali të nënrenditur, por vetëm në kushte të caktuara. E tillë ishte p.sh. folja (*më*) *takon.*
- Gjenden edhe folje që paraqesin kombinime të ndryshme në strukturën e tyre argumentore, madje dalin edhe me tri argumente të realizuara me fjali të nënrenditura.
- Një nga dukuritë që vihet re nga ky vështrim se foljet apo shprehjet foljore sinonime me njëra-tjetrën paraqesin përgjithësisht të njëjtën strukturë argumentore (krahaso: *dua/dëshiroj; tregoj/dëftej* etj.). Nga ana tjetër përdorimet e ndryshme apo nuancat e ndryshme kuptimore të së njëjtës folje, paraqesin struktura të ndryshme argumentore. Kjo është një dëshmi se struktura argumentore e një foljeje lidhet në radhë ta parë me kuptimin e saj.

Gjithsesi kjo pasqyrë nuk ishte shteruese, madje edhe për foljet që u panë nuk janë dhënë të gjitha kombinimet e mundshme, pasi do të përbente objektin e një pune të veçantë më të thelluar. Përfundimi i përgjithshëm që mund të nxirret, (*synimi* i këtij sythi), është që aftësia, mundësia apo nevoja e një foljeje të caktuar për të marrë si argument një fjali të nënrenditur (qoftë sintagmë komplementuese, qoftë sintagmë foljore e pashtjelluar), është tipar i brendshëm i foljes, pra varet nga kuptimi i saj, por disa herë varet edhe nga kushtëzime të tjera të rrethimit sintaksor.

### References

1. Buxheli, L. Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe. Tiranë: Neraida, 2007.
2. Crystal D. A Dictionary of Linguistics and Phonetics, botimi VI, i rishikuar. Blackwell Publishing, 2008.
3. Graffi, Sintaksa G. Strukturat e ligjëritimit; origjinali "Le structure del linguaggio. Sintassi, il Mulino, Bologna. Tiranë: Dituria, 1994, 2003.
4. Haegeman L. Government and Binding Theory. Blackwell, Oxford UK & Cambridge USA, Botimi II, 1998, 1994.
5. Kananaj A. Rrethanori në gjuhën shqipe. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2015.
6. Memushaj R. Tri koncepte themelore të sintaksës moderne". Studime Filologjike. 2008; 1-2:153-170.
7. Radford, A. Linguistics, An Introduction (botimi II): Cambridge University Press, 2009.
8. Tesnière Lucien. Éléments de syntaxe structurale. (Preface de Jean Fourquet), Paris, Librairie C. Klincksieck, 1959.